



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1- 67

Data 31.05.2023

Br.

Datum

OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në Ligjin nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor si dhe në dokumentin e planifikimit hapësinor në nivelin lokal Planin Zhvillimor Komunal, nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, pas shqyrtimit të kërkesës nga Reis Sallova, nga komuniteti i Lagjes "Washingtoni" nr. -I-9584/23, e dt.07.04.2023, dhe pas sqarimit të drejtorit të DPUKP-së, me nr.-V-442, të dt.28.04.2023, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Caktohet lokacioni i ri për ri vendosjen e Tregut në Njësinë Kadastrale nr.P-72614055-01885-0, me sipërfaqe prej 5801 m² e cila evidentohet në emër të Komunës së Obiliqit, e cila në anën veri lindore ka qasje në rr: "Mentor Dervishaj" ndërsa në anën veri perëndimore ka qasje në rr: "30 Marsi".
2. Zhvendosja e Tregut bëhet nga lokacioni aktual në lokacionin e ri me qëllim që banorët të kenë qasje në rr: "Washingtoni".
3. Meqë, "Infrakosi" është duke bërë revitalizimin e Hekurdhës, e cila atakon Komunën tonë, në këtë pjesë përballë Tregut ekzistues planifikohet ndërtimi i një nënkalimi, i cili iu mundëson qasje në rr: "Washingtoni" qytetarëve të cilët banojnë në anën tjetër të hekurdhës.
4. Investitori i objekteve banesore do të bartë të gjitha shpenzimet e lirimit të parcelës ekzistuese (Tregut dhe një objekti të pashfrytëzueshëm që gjendet afër Tregut) dhe po ashtu do të bartë të gjitha shpenzimet për vendosjen e Tregut në lokacionin e ri të caktuar nga Kuvendi Komunal brenda për brenda dimensioneve ekzistuese.
5. Vendimit i bashkëngjitet edhe pjesa grafike për Njësinë Kadastrale P-72614055-01885/0 me sipërfaqe prej 5801 e evidentuar në emër të Komunës së Obiliqit, në të cilën është planifikuar zhvendosja e tregut, që është e destinuar për ndërtim.
6. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
- Anëtarëve të Komisionit
- MAPL
- Arkivit



Kryesuese e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi